

**VENDIM**  
**Nr. 858, datë 21.10.2015**

**PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 16.7.2015, “METALLA DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË”  
(APLIKIMET NR. 30264/08, 42120/08, 54403/08 DHE 54411/08)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 16.7.2015, për çështjen “Metalla dhe të tjerë kundër Shqipërisë” (aplikimet nr. 30264/08, 42120/08, 54403/08 dhe 54411/08), sipas shumave të përcaktuara në shtojcën 2, të këtij vendimi, plus çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme.

2. Vlera e përcaktuar si detyrim në pikën 1, të këtij vendimi, të konvertohet në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

3. Shumat e përcaktuara si detyrim që ka shteti shqiptar, në pikën 1, të këtij vendimi, të depozitohen në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të aplikantëve, sipas shtojcës 1, të këtij vendimi, sipas vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 16.7.2015, për çështjen “Metalla dhe të tjerë kundër Shqipërisë” (aplikimet nr. 30264/08, 42120/08, 54403/08 dhe 54411/08).

4. Pagesa e shumave të depozituara, sipas pikës 3, të këtij vendimi, në favor të aplikantëve, sipas aplikimeve nr. 30264/08 (Metalla), nr. 42120/08 (Bushati), nr. 54403/08 (Metalla dhe të tjerë) dhe nr. 54411/08 (Metalla dhe të tjerë), të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit, brenda afatit tremujor, nga dita kur vendimi i Gjykatës është bërë përfundimtar.

5. Në rast mospagimi brenda afatit tremujor, të përmendur në pikën 4, të këtij vendimi, mbi shumat e mësipërme paguhen interesa të thjeshta, të barabarta me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind.

6. Efekti financiar i parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi i kontigjencës i buxhetit të shtetit.

7. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

# ANEKSI 1- LISTA E APLIKANTËVE

| Nr. | Çështja dhe numri                           | Emri i aplikantit (ve)<br>(viti i lindjes)                                                                                    | Shteti<br>rezident | Përfaqësuar nga          | Data<br>e kërkesës |
|-----|---------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|--------------------------|--------------------|
| 1.  | <i>Metalla</i> , nr. 30264/08               | Nezmi Metalla<br>(1943)<br>Bujar Metalla (1956)                                                                               | Shqipëri           | E. Muharremaj,<br>Avokat | 13 Qershor<br>2008 |
| 2.  | <i>Bushati</i> , nr. 42120/08               | Genc Bushati (1944)                                                                                                           | Shqipëri           | B. Muslija,<br>Avokat    | 9 Gusht<br>2008    |
| 3.  | <i>Metalla dhe të tjerë nr.</i><br>54403/08 | Nezmi Metalla<br>(1943)<br>Bujar Metalla (1956)<br>Shyqyri Metalla (1947)<br>Besnik Metalla<br>(1961)<br>Ferik Metalla (1969) | Shqipëri           | E. Muharremaj,<br>Avokat | 8 Tetor<br>2008    |
| 4.  | <i>Metalla dhe të tjerë</i> , nr. 54411/08  | <b>Dhurata Metalla,</b><br><b>mbiemri i vajzërisë</b><br><b>Duka (1956)</b><br>Sanije Sinjari (1928)<br>Fiqirete Gashi        |                    |                          |                    |

## ANEKSI 2–DËMI PASUROR DHE JOPASUROR, SI DHE KOSTOT DHE SHPENZIMET

| Emri i aplikimit dhe numri           | Dëmi pasuror dhe jo pasuror                                            | Kostot dhe shpenzimet              |
|--------------------------------------|------------------------------------------------------------------------|------------------------------------|
| Metalla, nr. 30264/08                | EURO 23,200 (njëzet e tre mijë e dyqind euro).                         | EUR 3,000 (tre mijë euro)          |
| Metalla dhe të tjerë<br>nr. 54403/08 | EURO 97,000 (nëntëdhjetë e shtatë mijë euro)                           |                                    |
| Metalla dhe të tjerë<br>nr. 54411/08 |                                                                        |                                    |
| Bushati, nr. 42120/08                | EURO 1,500 (një mijë e pesëqind euro në favor të pjesës së aplikantit) | Asgjë (asnjë faturë nuk u dërgua). |